



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2123/6 prot.

Datë 02.10.2023

V E N D I M
Nr. 982/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.10.2023 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-78044-08-22-2023, me objekt: “Loti 1: “Fizioterapi, logopedia dhe dhoma sensoriale”, me fond limit 4,357,290.00 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 07.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Qendra Komunitare për Personat me Aftësi të Kufizuar Tiranë.

Ankimues: Operatori ekonomik “ALMedical” SHPK me Nipt K2151102I dhe adresë Rruga “Shefqet Musaraj”, Banesa nr. 17, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Qendra Komunitare për Personat me Aftësi të Kufizuar Tiranë me adresë Rruga “Dritan Hoxha”, Njësia Administrative nr. 11 Laprakë, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 23.08.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-78044-08-22-2023, me objekt: “Loti 1: “Fizioterapi, logopedia dhe dhoma sansoriale”, me fond limit 4,357,290.00 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 07.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Qendra Komunitare për Personat me Aftësi të Kufizuar Tiranë.

II.2. Në datën 29.08.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është paraqitur nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, ankesa e operatorit ekonomik “ALMedical” SHPK, me numër ankimi elektronik A/2023/3386, protokolluar me nr. 2123/2023 prot., datë 29.08.2023, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4 Me shkresën me nr. 2123/2 prot., datë 04.09.2023 me lëndë “*Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “ALMedical” SHPK*”, Komisioni i Prokurimit Publik në përputhje me nenin 114 të LPP-së, i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë brenda ditës së nesërme nga marrja e shkresës, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i hartimit dhe miratimit të kriterëve të veccanta për kualifikim, si dhe vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “ALMedical” SHPK.

II.5. Me shkresën me nr. 2123/3 prot., datë 20.09.2023 me lëndë “*Rikërkesë*”, Komisioni i Prokurimit Publik në përputhje me nenin 114 të LPP-së, i ka rikërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë brenda ditës së nesërme nga marrja e shkresës, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i hartimit dhe miratimit të kriterëve të veccanta për kualifikim, si dhe vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “ALMedical” SHPK.

II.6. Me shkresën datë 20.09.2023, protokolluar me tonën me nr. 2123/4 prot., datë 21.09.2023 me lëndë “*Kthim përgjigje*”, dërguar autoritetit kontraktor dhe për dijeni Komisionit të Prokurimit Publik operatori ekonomik Almedical SHPK na vë në dijeni se: “[...]Në datën 19.09.2023 në adresën e operatorit ekonomik Almedical është paraqitur shkresa me nr. 168 prot., e datës 15.09.2023 me kthim përgjigjen nga autoriteti kontraktor “*Qendra Komunitare për personat me aftësi të kufizuara: në lidhje me ankesën e bërë për procedurën me objekt Loti 1: “Fizioterapi, logopedia dhe dhoma sansoriale” me numër reference REF-78046-08-22-2023.*

Kjo shkresë i drejtohet operatorit ekonomik dhe për dijeni të Agjencisë së Prokurimit Publik . (Bashkëngjitur është shkresa, së bashku me zarfin e protokolluar).

Sipas shkresës citohet nga AK që: “Në datë 14.09.2023 pranë Qendrës Komunitare “Për personat me aftësi të kufizuara” është paraqitur një ankesë nga operatori ekonomik Almedical shpk me nr. 2123/2 datë 04.09.2023 në lidhje me detyrimin e autoritetit kontraktor Qendra Komunitare “Për personat me aftësi të kufizuara ndaj këtij operatori.

Ne Almedical, ju sqarojmë që nuk kemi paraqitur ankesë në këtë datë, dhe sipas referencës së numrit të dokumentit 2123/2 prot. Dhe datës 04.09.2023, bëhet fjalë për shkresën që Komisioni i Prokurimit Publik i është drejtuar AK për të kthyer përgjigje brenda afatit për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik Almedical.

Në fund të shkresës autoriteti kontraktor citon që nuk ka asnjë njoftim në lidhje me ankesën e datës 29.08.2023.

Me anë të kësaj shkrese, ne operatori ekonomik “Almedical” ju sqarojmë që ankesa e kryer nga ana jonë për procedurën e sipërpërmendur është bërë online, nëpërmjet portalit e-albania, brenda afatit të përcaktuarnë ligjin e LPP. Numri i aplikimit të ankesës është A/2023/3386. Ne momentin që bëhet aplikimi nëpërmjet portalit e-albania, ankesa i shkon menjëherë KPP edhe autoritetit kontraktor përkatës.

Për ta vërtetuar këtë gjë është edhe lajmërimi që sjell portali e-albania sipas statusit të ankesës. Kështu sapo ankesa është dërguar online vjen njoftimi i parë që “Aplikimi juaj u dërgua me sukse”, më pas njoftimi i dytë që ankesa është në statusin “E paraqitur” dhe njoftimi që autoriteti kontraktor e ka marrë ankeën nëpërmjet njoftimit të tretë “Në proces shqyrtimi nga AK” (Bashkëngjitur gjeni njoftimet e ardhura në portal nga sistemi bashkë me fazën aktuale të ankesës që citohet “Në proces shqyrtimi nga AK) [...]”.

II.7. Me shkresën me datë 20.09.2023, protokolluar me tonën me nr. 2123/5 prot., datë 21.09.2023 drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, operatori ekonomik “Almedical” SHPK ka paraqitur informacion shtesë si vijon: “[...]Në datë 29.08.2023 operatori ekonomik “Almedical shpk ka paraqitur ankesën për këtë procedurë nëpërmjet portalit e-albania. Autoriteti kontraktor nuk ka kthyer përgjigje mbi ankesën e ngritur, si dhe në sistem nuk është pezulluar procedura, duke qënë e hapur për pjesëmarrje.

Bashkëngjitur gjeni njoftimin nga autoriteti kontraktor, që vërteton që procedura është zhvilluar normalisht, duke qënë në kundërshtim të plotë me ligjin e prokurimeve. Duke ënë se Almedical ka paraqitur ankesë nga KSHA nuk ka dhënë përgjigje mbi shqyrtimin e ankesës, atëherë nuk mund të zhvillohej procedura pa dhënë vendimin KPP mbi ankesën dhe lejimin me hapat e mëtejshëm të procedurës. Prandaj kërkojmë anulimin e procedurës dhe shqyrtimin e ankesës për procedurën”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, vlen të theksojmë se operatori ekonomik “Almedical” SHPK ka paraqitur ankim në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit, si pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet Sistemit Elektronik të Ankesave.

Sa më sipër, vlen të theksojmë, se në datën 27.10.2021, Komisioni i Prokurimit Publik ka implementuar sistemin e Regjistrimit Elektronik të Ankesave, duke mundësuar tashmë për të gjithë operatorët ekonomikë paraqitjen e ankesës në të njëjtën kohë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në rrugë elektronike. Me dorëzimin e ankesës në sistemin elektronik, në përputhje me afatet në ligjin 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ankesa menjëherë konsiderohet e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, njëkohësisht në të dyja institucionet. Ankesa dhe e gjithë përmbajtja e saj është e aksesueshme nga autoriteti kontraktor, në Sistemin Elektronik të Ankesave.

Gjithashtu me vendimin nr. 329, datë 06.04.2022 “Për miratimin e manualit të autoriteteve kontraktore për përdorimin e sistemit të ankesave elektronike dhe shqyrtimin e ankesave nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike”, Komisioni i Prokurimit Publik ka miratuar manualin për autoritetet kontraktore për përdorimin e sistemit të ankesave elektronike dhe shqyrtimin e ankesave nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike.

KPP sqaron se, me paraqitjen e ankesës nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar ankesën e plotë në faqen zyrtare, akoma më tej me shkresën me nr. 2123/2 prot, datë 04.09.2023 dhe me shkresën me nr. 2123/3 prot, datë 20.09.2023 Komisioni i Prokurimit Publik me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesës, në përputhje me nenin 114 të LPP-së i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë informacion lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “ALMedical” SHPK.

Duke qenë se edhe pas kërkesave për informacion të KPP-së drejtuar autoritetit kontraktor, nga ana e këtij të fundit nuk është dërguar asnjë informacion lidhur me procedurën e prokurimit objekt-ankimi, duke mos përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 114 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, për vënien në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, të shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës, KPP do të shqyrtojë kryesisht pretendimet e operatorëve ekonomikë ankimues.

III.1.1 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “ALMedical” ShPK, se: “[...]Fizioterapia dhe logopedia janë dy shkenca të ndryshme të fushës së mjekësisë. Fizioterapia përfshin vlerësimin, diagnostifikimin, trajtimin fizik të pacientëve në shumë specialitete. Ndërsa logopedia merret me parandalimin, zbulimin, diagnostifikimin dhe trajtimin e crregullimeve të gjuhës, të folurit, zërit, gëlltitjes, leximit dhe shkrimit.

Artikujt për fizioterapinë janë pajisje laboratorike, të cilat ndihmojnë një pacient që të recuperojë një dëmtim fizik që ai mund të ketë, nga shkaqe të ndryshme. Konkretisht artikujt nga numri 1 deri tek numri 21.

Ndërsa artikujt për logopedinë janë mjete didaktike të cilat ndihmojnë në zhvillimin e fëmijëve, por nuk kanë lidhje me pajisjet laboratorike. Që janë artikujt nga numri 22 deri tek numri 196 (i fundit)

Natyra e artikujve të përdorur për këto dy fusha është e ndryshme, dhe nuk kanë lidhje me njëra tjetrën.

Kjo gjë kufizon artificialisht konkurrencën e lirë, duke zvogëluar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

“[...]Kërkojmë nga autoriteti kontraktor që të ndajë në lotë lote të veçanta fizioterapinë dhe logopedinë.

Gjithashtu kërkojmë nga autoriteti kontraktor të japë shpjegimin e termit “dhoma sensoriale”. Pas kërkimeve në internet dhe rrjete sociale nuk ka të dhëna për këto modele dhomash. Kërkojmë nga AK që të ndahet në lot më vete dhomat sensoriale.

Si përfundim, kërkojmë nga AK që të ndajë procedurën në 3 lote të ndryshme për fizioterapi, logopedi dhe dhoma sensoriale[...].”

III.1.2 Në shtojcën 6 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit” të dokumentave të tenderit përcaktohet:

Shtojca 6

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit dhe afati i levrimit :

Loti 1: “Fizioterapi ,logopedia dhe dhoma sensoriale ”:

Nr.	Pershkrimi	Sasia	Destinacioni	Periudha e dorezimit
1	Tecar therapy	1	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
2	Krevat	1	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
3	Magneto	1	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
4	Combo	1	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
5	Shkalle suedeze	1	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
6	Bicikletë statike për fizioterapi e madhe	1	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
7	Peshore profesionale	1	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
8	Masazhatore	1	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
9	Pistë vrapimi	1	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
10	Top bobath (physio roll) (i shtypur në mes, 65cm)	3	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
11	Tapet ushtrimesh (2 cm trashësi)	7	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
12	Llastik ushtrimor për dorën dhe gishtat	4	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
13	Gira me pesha 0.5-5 kg	3	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
14	Tavoline pingpongu	1	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
15	Set pingpongo	2	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
16	Thas Boksi	2	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
17	Doreza Boksi	4	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
18	Kosh basketbolli	2	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
19	Role fizioetrapie	5	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
20	air balance disk (me gjemba)	3	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
21	Vaj masazhi,	5	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
22	shkalle metalike profesionale	1	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates

23	plastifikim numrat me emertim	100	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
24	spatul logopedia	30	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
25	plastifikim objekte te ndryshme me emertim	100	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
26	plastifikim lulet me emertim	100	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
27	plastifikim kafshet, shpendet, insektet me emertim	100	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
28	plastifikim alfabeti shqip me emertim	100	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
29	plastifikim alfabeti ne rrokje	100	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
30	plastifikim ene kuzhine me emertim	100	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
31	plastifikim figurat e frutave me emertim	100	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
32	plastifikim veshjet e njeriut me emertim(fund, pantallona etj)	100	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
33	plastifikimi i pjesëve të trupit me emertim	100	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
34	plastifikim familja me emertim	100	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
35	plastifikim figurat e ushqimeve me emertim	100	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
36	plastifikim kafshet me emertim	100	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
37	Shtëpi kukulle me rrotullim	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
38	Pazzel familja	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
39	kukull djale dhe vajze	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
40	Shtëpi kukulle me rrotullim	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
41	Parking	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
42	Karrotrec	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
43	Shkronja druri(alfabeti)	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
44	Loja mos u nxeh	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates

45	Glob puzzle	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
46	Teleskop	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
47	Dylbi	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
48	Domino	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
49	Mikroskop	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
50	Enë Kuzhine	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
51	Kitarë	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
52	Lojra Tavoline	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
53	Rruaza	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
54	Flamingo	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
55	Ferma	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
56	Sirena	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
57	Lindja e një Dallandysheje	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
58	Lola luan si mama	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
59	liza luan mesuese	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
60	Zjarrefiksja e Leos	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
61	Libri im I parë I kopshtit të frutave dhe perimeve	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
62	3 Derrkucat (pop up)	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
63	Libër. Shëet mos zgjojmë kafshët e fermës	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
64	Libër, Cfarë pëlqen Kotelja?	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
65	Libër, Cfarë pëlqen Qenushi?	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
66	Labirinth	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
67	Lodër me tërheqje qeni	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates

68	Lodër me tërheqje lepur	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
69	Lodër me tërheqje gomar	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
70	Lodër me shtytje ariu	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
71	Lodër me shtytje lopë	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
72	Lodër me shtytje qeni	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
73	Lodër me shtytje bletë	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
74	lokomitivë e vogël me tërheqje	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
75	Lokomotivë e madhe me tërheqje	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
76	Pata me tërheqje	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
77	Kolovajtëse didaktike	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
78	Kubik arsimor	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
79	Shtëpi didaktike	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
80	Lojë didaktike qyteti	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
81	Dindolino	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
82	Unaza	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
83	Tren	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
84	Mini 3 D Puzzle policia	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
85	Mini 3 D Puzzle ndihma e shpejtë	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
86	Mini 3 D Puzzle zjarrfikës	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
87	Labirint I vogël me rruaza	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
88	Labirint i madh me rruaza	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
89	Kub aktiviteti	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
90	Kuba në kovë	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates

91	Kështjella	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
92	Kube didaktike	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
93	Minipazëll ariu	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
94	Minipazëll traktori	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
95	Minipazëll luani	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
96	Minipazëll flutura	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
97	Minipazëll kërmilli	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
98	Minipazëll bletëza	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
99	Minipazëll mollëkuqja	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
100	Pazëll kali	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
101	Pazëll qeni	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
102	Pazëll makina	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
103	Pazëll treni	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
104	Pazëll Vishe Arushin	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
105	Radhitëse 2 në 1	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
106	Radhitëse 2 në 1 "Arka e Noes"	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
107	Radhitëse kafshësh	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
108	Set pazëll	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
109	Set pazëll	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
110	Pazëll- kafshët e egra	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
111	Pazëll- kafshët shtëpiake	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
112	Radhitëse peshkimi me magnet	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
113	Radhitëse- Vishe djalin	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
114	Radhitëse- Vishe vajzën	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates

				kontrates
115	Radhitëse- ferma	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
116	Radhitëse- mjete udhëtimi	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
117	Labirinth Xhungla	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
118	Labirinth Ferma	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
119	Pino logjike	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
120	Pino logjike	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
121	Kube Përralla	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
122	Kube Ferma	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
123	Ora	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
124	Radhitëse -numrat	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
125	Radhitëse -matematika	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
126	Numrator	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
127	Alfabeti shqip	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
128	Pazëll 2-she	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
129	Loja e kujtesës	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
130	Loja "Mos u nxeh" piratët	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
131	Loja "Mastermind	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
132	Domino- ferma	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
133	Domino- xhungla	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
134	Domino -fruta	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
135	Tangram	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
136	Mini radhitëse	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
137	Pema e barazpeshës	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates

138	Mjetet e mjekut	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
139	Mjetet e mekanikut	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
140	Set treni me hekurudhë	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
141	Set i tabelave të qarkullimit rrugor	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
142	Ksilofon me ngjyra	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
143	Daulle e madhe	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
144	Bilbil I madh	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
145	Fugë	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
146	Daire	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
147	Raketake	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
148	Bori	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
149	Harmonikë	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
150	Lokomotivë me kurdisje	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
151	Aeroplan me kurdisje	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
152	Makina	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
153	loder me kafshe të ndryshme	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
154	Litar	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
155	Lodër fleksibël	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
156	Lodër me toptha	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
157	Varëse rrobash	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
158	Kamion druri me makina	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
159	Kamion me figura gjeometrike	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates
160	Kube ndërtuese	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimnit te kontrates

161	Pistë makinash me 4 rrugë	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
162	Kamioni i punëtorit me vegla	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
163	Kamioni përzierës i mjeteve didaktike	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
164	Unaza didaktike me numra	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
165	Tabela 2 në 1	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
166	Kali lëkundës	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
167	Boëling	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
168	Tavolina e punëtorit 2 në 1	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
169	Shtëpi prej druri me cekic dhe topa	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
170	Biciklete druri, biciklete pa pedale	3	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
171	ABC puzzle krokodil	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
172	Ora të mëdha muri	6	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
173	speech buddies	1	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
174	sensory cheë stick	1	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
175	Talk Tools Textured Cheëy Combo	1	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
176	Special supplies buzz buddy oral stimulation	1	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
177	Special supplies sensory mounth brushes	1	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
178	Special supplies duo spoon oral motor therapi	1	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates
179	Special supplies bumble bee sensory vibrating pilloë	1	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimimit te kontrates

180	Special supplies lady bog sensory vibrating pilloë	1	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
181	Special supplies vibrating pilloë	1	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
182	talktools sensi oral sensory tool	1	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
183	special supplies AAC Communication Device	1	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
184	tongue tip exerciser	3	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
185	gafly X's dhe Y's	5	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
186	talk tolls sensisensory integration kit	1	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
187	ARK's grabbes and grobber XT2	1	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
188	Special supplies sensory month brodhes	1	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
189	Talk tolls horn kit	1	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
190	ëooden letters practicing board	1	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
191	toothettes	1	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
192	Bubble tube	1	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
193	fibra optike	1	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
194	aromaterapi	1	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
195	Projektor tavani	1	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates
196	Tambural	1	QKPAK	30 dite nga dita e nenshkrimite kontrates

III.1.3. Referuar ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 2, parashikohet shprehimisht se: “Qëllimi i këtij ligji është:

a) të rrisë efijencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.4. Në nenin 39 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të japë një kontratë në formën e loteve të veçanta, duke përcaktuar madhësinë dhe objektin e këtyre loteve. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”

III.1.5. Në përputhje me nenin 24 pika 3 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në marrjen e vendimeve (Komisioni i Prokurimit Publik) mban parasysh, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit.

III.1.6. Në nenin 42, pika 1 dhe 2 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet se: “1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve. 2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit.” [...].

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit dhe lloji i procedurës së prokurimit, vihet re se kjo procedurë ka për qëllim furnizimin e autoritetit kontraktor me **mallra për përdorim fizioterapi, logopedi, dhoma sansoriale**. Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik thekson se ndarja ose jo, e kontratës në lote, është një vendim i rëndësishëm që autoriteti kontraktor merr gjatë procesit paraprak të prokurimit (hartimit të kriterëve kualifikuese nga njësitë e prokurimit), pasi ndikon drejtpërdrejtë në nivelin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi. Kjo bëhet duke mbajtur në konsideratë elemente të tilla si: tregu, konkurrenca e mundshme, vlera e prokurimit, etj., dhe veçanërisht faktin nëse objekti i kontratës është një punë/shërbim/mall për të cilin ofertuesit janë të paktë, pra, gëzojnë në një farë mënyre të drejtën e prodhimit, apo distribucionit.

III.1.8. Komisioni gjykon, se nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit dhe i llojit të mallrave të kërkuara për furnizim nga autoriteti kontraktor, konstatohet, se kemi të bëjmë me mallra të cilat kanë përdorime të ndryshme, përkatësisht për fizioterapi, logopedi, dhe dhoma sensoriale. Gjithashtu, në procesverbalin “*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim*” autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar dhe nuk e justifikon përfshirjen në një lot të vetëm të aparaturave objekt prokurimi. Komisioni gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor për përfshirjen në një lot të vetëm fizioterapi, logopedi dhe dhoma sensoriale kufizon konkurrencën pasi mund të jetë e vështirë për tu përmbushur nga operatorët ekonomikë. Akoma më tej referuar listës së mallrave objekt prokurimi Komisioni gjykon se mallrat që përdoren për fizioterapi, logopedi dhe dhoma sensoriale kanë përdorime të ndryshme dhe kjo shkakton zvogëlim të konkurrencës, pasi mund të kualifikohen vetëm ata operatorë ekonomikë të cilët i tregtojnë të tre llojet e produkteve, pavarësisht se këto të fundit janë natyra të ndryshme mallrash. Në këto kushte, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të bëjë ndarjen në lote të procedurës së prokurimit sipas natyrës së mallrave duke rritur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë si dhe hapur konkurrencën.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2 Lidhur me pretendimin e operatori ekonomik me argumentimin se: “*Gjithashtu kërkojmë nga autoriteti kontraktor të japë shpjegimin e termit “dhoma sensoriale”. Pas kërkimeve në internet dhe rrjete sociale nuk ka të dhëna për këto modele dhomash*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1 Neni 75 i ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikon se: “*1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.*

Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.

Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce.

Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor mund të zgjasë afatin kohor të pritjes së ofertave.

Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e dytë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

3. Çdo shtojcë për ndryshim të dokumenteve të tenderit komunikohet në të njëjtën mënyrë që është bërë publikimi i njoftimit të procedurës.

III.2.2 Referuar nenit 75 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” ku përcaktohet se: “Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit”, KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të sqarojë operatorët ekonomikë lidhur me shpjegimin e termit “*dhoma sansoriale*”, si dhe tua komunikojë të gjithë operatorëve ekonomikë që kanë tërhequr dokumentet e tenderit në mënyrë që të behet i njohur për të gjithë.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenit 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji përcaktohet shprehimisht: “*Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj*”. Në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]”. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara

procedurale në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (Neni 4 i Kodit të Procedurës Administrative). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Në rastin konkret, autoriteti kontraktor me veprimet e tij, ka kryer shkelje procedurale duke vazhduar me hapat e mëtejshëm të procedurës, duke zhvilluar procedurën pa nxjerrë KPP një vendim që lejon vijimin e saj, ndaj, përbën shkak për anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Në këto kushte, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi.

III.3.1. Gjithashtu, referuar dokumentacionit të administruar në dosje bazuar në nenin 23 “Kompetencat e Agjencisë së Prokurimit Publik” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, KPP gjykon, se duhet t’i propozohet Agjencisë së Prokurimit Publik nisja e hetimit administrativ në lidhje me zhvillimin e procedurës nga ana e autoritetit kontraktor.

III.4. Referuar dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, rezulton, se autoriteti kontraktor nuk ka dhënë informacion lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Almedical” SHPK.

Me shkresën nr. 2123/2 prot., datë 04.09.2023 me objekt: “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “ALMedica” SHPK , Komisioni i Prokurimit Publik i është drejtuar autoritetit Kontraktor Qendrës Komunitare për Personat me Aftësi të Kufizuara, me kërkesën për dhënie informacioni brenda ditës së nesërme të marrjes së kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i hartimit dhe miratimit të dokumentave standarde të tenderit, procesi i hartimit dhe miratimit të kriterëve të veçanta për kualifikim, si dhe vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me tratimin e ankesës së operatorit ekonomik “Almedical” SHPK.

Nga ana e autoritetit kontraktor nuk është dërguar informacion për procedurën e mësipërme.

Gjithashtu me shkresën nr. 2123/3 prot., datë 20.09.2023 me lëndë: “Rikërkesë”, Komisioni i Prokurimit Publik i është drejtuar përsëri autoritetit Kontraktor Qendra Komunitare e Personave me Aftësi të Kufizuara, duke e rikujtuar për detyrimin për dhënie informacioni për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-78044-08-22-2023, me objekt: “Loti 1, Fizioterapi, Logopedi dhe dhoma sensoriale”, me fond limit 4,357,290 lekë pa TVSH, parashikuar për tu

zhvilluar në datë 07.09.2023 nga autoriteti kontraktor Qendra Komunitare e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Edhe në vijim të komunikimit të dytë nuk ka patur përgjigje nga Autoriteti Kontraktor, duke mos bashkëpunuar me Komisionin e Prokurimit Publik për dhënie informacioni për procedurën objekt-ankimi, në përmbushje të detyrimit ligjor. Autoriteti kontraktor, Qendra Komunitare e Personave me Aftësi të Kufizuara me veprimet dhe mosveprimet e tij ka shkaktuar tejzgjatje të procedurës për shqyrtimin e saj.

III.4.1. Në nenin 131 pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se : *“1. Refuzimi i autoritetit ose entit kontraktor për të bashkëpunuar me Komisionin e Prokurimit Publik dhe Agjencinë e Prokurimit Publik ngarkon me përgjegjësi titullarin e autoritetit kontraktor dhe dënohet nga këto institucione me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë. 2. Masa e gjobës vendoset në raport me vlerën e përlogaritur të kontratës dhe sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik”.*

Në këtë kuptim, referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se me anë të mosveprimit, autoriteti kontraktor ka refuzuar të bashkëpunojë me Komisionin e Prokurimit Publik, duke mos dërguar informacion edhe pas insistimit të këtij të fundit, në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “ALMedical” SHPK, në kuptim të nenit 110 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”

III.4.2 Sa më sipër, në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës së procedurës së prokurimit, si edhe duke marrë në konsideratë faktin se zyrtari përgjegjës nuk është përsëritës në shkëlqen administrative, në mbështetje të nenit 24 nenit 131 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Ligjit Nr. 10279 datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, vendos të marrë masën administrative gjobë në masën 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë për Znj. Arlinda Bilali Titullar i Autoritetit Kontraktor Qendra Komunitare e Personave me Aftësi të Kufizuara, për mosbashkëpunim me Komisionin e Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-78044-08-22-2023, me objekt: “Loti 1, Fizioterapi, Logopedi dhe dhoma sensoriale”, me fond limit 4,357,290 lekë pa TVSH.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi

pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Almedical” SHPK për procedurën e prokurimit prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-78044-08-22-2023, me objekt: “Loti 1: “Fizioterapi, logopedia dhe dhoma sensoriale”, me fond limit 4,357,290.00 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 07.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Qendra Komunitare për Personat me Aftësi të Kufizuar Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rishpalljen e procedurës së prokurimit, të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Të marrë masën administrative gjobë në masën 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë për Znj. Arlinda Bilali, Titullar i Autoritetit Kontraktor Qendra Komunitare për Personat me Aftësi të Kufizuar Tiranë, për mosdërgim informacioni në Komisionin e Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-78044-08-22-2023, me objekt: “Loti 1: “Fizioterapi, logopedia dhe dhoma sensoriale”, me fond limit 4,357,290.00 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 07.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Qendra Komunitare për Personat me Aftësi të Kufizuar Tiranë.
4. Kjo gjobë përbën titull ekzekutiv.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kundër vendimit për marrjen e masës administrative (gjobë) mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, në përputhje me Ligjin nr. 10279 datë 20.5.2009 “Për kundërvajtjet administrative”
7. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
8. T’i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ për konstatimet e mësipërme, si edhe të dërgohet pranë APP-së kopje e materialeve të administruara në shqyrtimin administrativ nr. 2123 prot., datë 29.08.2023.
9. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “ALMedical” SHPK.

10. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Monitorimit Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror.

11. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri